



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Procedura e mbështetjes financiare për Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018"



I - QELLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i kësaj procedure është përcaktimi i kriterëve për mbështetjen financiare ndaj anëtarëve të KOKSH, pjesëmarrës në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018".

Objektivat për dhënien e kësaj mbështetjeje financiare janë:

1. të lehtësojë aplikuesit për ndjekjen e procedurave,
2. të qartësojë kriteret e përfitimit të mbështetjes financiare,
3. zbatimimi dhe kontrolli i procedurave

II - PËRFITUESIT

Të drejtën për të aplikuar dhe përfituar mbështetjen financiare në këtë program e kanë vetëm Federatat e sporteve individuale të cilat kanë konfirmuar pjesëmarrjen në Lojërat Mesdhetare Tarragona 2018"

III - PËRSHKRIMI

Çdo anëtar i përcaktuar më lartë i cili aplikon për një mbështetje financiare, duhet të paraqesë një Aplikim Projekti të plotë për përgatitjen e ekipit pjesëmarrës në këto lojëra. Mbi të dhënat e projektit është e detyrueshme të plotësohet formulari i aplikimit (Aneks 1 i procedurës së mbështetjes financiare nga KOKSH)

Aplikuesi duhet të ketë parasysh që mbështetja financiare e miratuar do të përdoret vetëm për mbulimin e shpenzimeve të mëposhtme:

- Shpenzime për grumbullimin deri në 10 ditë me kosto 50 USD/personi në ditë me TVSH

IV - PROCEDURA E APLIKIMIT

Shkresa shoqëruese e Federatës përkatëse dhe formulari i aplikimit të detajuar duhet të paraqiten pranë Sekretariatit të KOKSH dhe të protokollohen [brenda datës 29 Maj 2018](#). Federata Sportive duhet të pranojë në çdo moment kontroll të pavarur të zgjedhur nga KOKSH.



Kontakt



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

V - MIRATIMI

KOKSH do të analizojë aplikimim (kërkesën) për mbështetje financiare për grumbullimin e ekipit dhe anëtarët e përcaktuar nga Komisioni Teknik i KOKSH do të ndjekin vijueshmërinë e grumbullimit.

VI - RAPORTIMI

Pagesa e projekteve të miratuar do të bëhet pas përfundimit të grumbullimit dhe paraqitjes pranë KOKSH të dokumentacionit të më poshtëm.

Raporti Financiar (Aneksi 3) i detajuar dhe shoqëruar me: faturat përkatëse sipas Ligjit, Urdhër Prokurimi, Proçes verbal, kontrata me ofertuesin fitues, lista e detajuar e pjesëmarrësve firmosur nga hoteli dhe përfaqësuesi ligjor i Federatës, të dhënat bankare të përfituesit.

Raporti teknik (Aneksi 2) të detajuar dhe shoqëruar me foto nga grumbullimi dhe stërvitja.

Dokumentacioni i dorëzuar do të analizohet nga grupi i punës dhe pas miratimit do të bëhet lëvrimi i fondeve.

Gjithashtu i gjithë dokumentacioni përfundimtar do të jetë i shoqëruar me formularin e dorëzimit të dokumentacionit (Aneksi 4) të firmosur nga titullari dhe me vulë.

VII - ANEKSET

1. Formulari i aplikimit
2. Raporti teknik
3. Raporti financiar
4. Formular dorëzimi dokumentacioni financiar



Kontakt